REPUBLIKA E SHQIPERISE
YOU TRAVEL SHPK
Bul.Zogu i Pare, Qendra tregtare Tirana, Kt.7
Tirane

VENDIM
I ORTAKUT TE VETEM
Nr. 1 date 11.11.2021

Sot me date 11.11.2021, u mblodh ne seline e shoqerise ortaku i vetem i "YOU TRAVEL" shpk Z. Joanna Abraham, i cili perben 100% te kuotave te kapitalit. Ortaku i vetem i shoqerise, pasi shqyrtoi rendin e dites:

VENDOSI

1. Saktesimin e nenit 5 te Kreut II te statutit te shoqerise duke vendosur vleren e kapitalit 1,000,000 (nje milion) leke dhe jo sic eshte shenuar ne statutin fillestar 10,000,000 (dhjete milion) leke. Gabimi i ndodhur ka ardhur si pasoje e nje ngatarrese me leke te vjetra e te reja.

   Per sa me siper Neni 5 ndryshon si vijon:

   Kreu II

   Kapitali

   Neni 5

   Kapitali themeltar

   Kapitali themeltar i kesaj shoqërie përbehet në para (Lekë) në shumën prej 1,000,000 (nje milion) Lekë me 1 (nje) pjesë.

   Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:

   1.Ortaku themelues Joanna Abraham – zoteruese i 1 (një) kuote, në vlere 1,000,000 (nje milion) lek që përbën 100% të kapitalit.

   Kapitali themeltar ose pjesë të caktuara të tij janë të transefrueshme nga Ortakët e kësaj shoqërie tek të tretët.

YOU travel
NUIS: M12228002S
Tirana - Albania

Të gjitha veprimatarite e shoqërisë mbi kapitalin themeltar në natyrë bëhen vetëm me miratimin e Asamblese së ortakëve. Vlerësimi i këtij kapitali bëhet nga ortaket e shoqërisë dhe me vendim të Asamblese se Ortakeve dhe nga një ekspert i autorizuar i caktuar nga vetë Asambleja e Ortakeve. Shoqeria "YOU TRAVEL" Shpk, për detyrimet që do të lindin gjatë aktivitetit të saj me të tretët përgjigjet vetëm me pasuritë e saj. Ortakëte kësaj shoqërie nuk përgjigjen për detyrimet e kësaj shoqërie me pasuritë e tyre që nuk janë futur në kapitalin e kësaj shoqërie.Pjesmarrja në këtë shoqëri nuk i pengon ortaket të kenë pavarësi ligjore, organizative dhe të drejta pronësie jaashtë kësaj shoqërie.

2. Depozitimin e ketij vendimi prane QKB.

Ky vendim hyn ne fuqi menjehere.

**ORTAKU I VETEM I SHOQERISE**

Znj. Joanna Abraham

Joanna Abraham

YOU travel
NUIS: M12228002S
Tirana - Albania